

## STATUTI

### I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR "TECHFIN" SHPK

Në mbështetje të Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", - i ndryshuar, Ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit" - i ndryshuar, veprimtaria e shoqërisë do të organizohet dhe drejtohet sipas dispozitave të këtij Statuti.

#### Neni 1

##### Forma Ligjore, Emri dhe Themeluesit

Emri i shoqërisë do të jetë **"TECHFIN" SHPK**, nga këtu e më poshtë referuar edhe si "shoqëria", e cila themelohet si një shoqëri tregtare në formën e "Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "SHPK".

Themeluesit e shoqërisë janë:

- **Znj. Bruna MUSARAJ**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 11/05/1988 banuese në Tiranë, identifikuar me Nr. I85511011S, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- **EB INVESTMENT SHPK**, një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me adresë në: Hyrja 2, Pallati 7/1, Rruga Ismail Qemali, Tiranë, Shqipëri, me NIPT: M31324009L, përfaqësuar nga Administratorja Znj. Erinda Xhaferraj, shtetase shqiptare, e datëlindjes 16/06/1989, banuese në Tiranë, identifikuar me Nr. Personal I95616062W, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

#### Neni 2

##### Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetet e mëposhtme:

- Zhvillimi, implementimi dhe mirëmbajtja e sistemeve informatike dhe softëare-ëve ERP
- Ofrimi i shërbimeve digjitale dhe IT
- Konsulencë në fushën e teknologjisë së informacionit
- Këshillim për platformat e administrimit të biznesit dhe platformat digjitale
- Konsulencë për transformimin digjital të kompanive

#### Neni 3

##### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

#### Neni 4

##### Selia

Selia e shoqërisë do të jetë në adresën: Hyrja 2, Pallati 7/1, Rruga Ismail Qemali, Tiranë.

Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si dhe mund të marrë pjesë në shoqëri të tjera shqiptare dhe/ose të huaja, që ekzistojnë, ose do të krijohen në të ardhmen. Këto mund të krijohen ose mbyllen me një vendim të thjeshtë të administratorit.

## Neni 5

### Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 Lekë (**njëqind mijë lekë**). Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaku themelues: **Znj. Bruna MUSARAJ**, kontribut në para, 50,000 Lekë (**pesëdhjetë mijë lekë**), kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë 50%.
2. Ortaku themelues: **EB INVESTMENT SHPK**, kontribut në para, 50,000 Lekë (**pesëdhjetë mijë lekë**), kuota e zotërimit të kapitalit të shoqërisë 50%.

## Neni 6

### Kërkesa për të paguar kuotat dhe tërheqja e kuotave të paguara

- a) Administratori mund t'u kërkojë ortakëve të shoqërisë pagesën e kontributeve të pashlyra në lidhje me kuotat e tyre dhe çdo ortak pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për kuotat e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papapguara. Personi të cili i detyrohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëposhtëm të pronësisë së kuotave me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.
- b) Zotëruesit e përbashkët të një kuote do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.
- c) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatvonesë vjetore të barabartë me interesin e bonove të thesarit vjetor të qeverisë shqiptare, duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.
- d) Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, Administratori mund të njoftojë paraprakisht të paktën katërmëdhjetë Ditë të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumën e mundshme shtesë të kamatvonesës. Njoftimi do të përmbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast mos zbatimi të tij, kuotat të cilave u referohet njoftimi do të anulohen.
- e) Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit të njoftimit, kuota me të cilin lidhet njoftimi, përpara se të kryhet pagesa e kërkuar sipas njoftimit, mund të anulohet me vendim të Administratorit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumën e tjera të pagueshme në lidhje me kuotat e anuluar dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.
- f) Në pajtim me dispozitat ligjore, kuota e anuluar mund të shitet, rishpërndahet ortakëve ose të kalohet sipas afateve dhe mënyrave që Administratori konsideron të përshtatshme.
- g) Personi, kuota e të cilit është anuluar, humbet cilësinë e ortakut në lidhje me këtë kuota por do të jetë përgjegjës ndaj shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky ortak ndaj shoqërisë datën e anulimit të kuotës së bashku me kamatvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të kuotës.

## Neni 7

### Llojet e Kuotave, të Drejtave dhe Kufizimeve

Në përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa çenuar të drejtat që rrjedhin nga kuotat ekzistuese, kuotat mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave së ortakëve, në përputhje me parashikimet e Nenit 87 të Ligjit 9901.

## Neni 8

### Certifikatat e Kuotave

Secili ortak ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshojë më shumë se një certifikatë për kuotat e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës ndaj përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të kuotave do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të kuotave, në përputhje me pikën 2 të nenit 72 të ligjit. Emrat e zotëruesve si të përbashkët të kuotave do të renditen në certifikatën e kuotës. Certifikata nuk do të gëzojë cilësinë e letrës me vlerë.

## Neni 9

### Mënyrat e fitimit dhe kalimit të kuotave

- Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rregjim prej tyre mund të fitohen apo kalojnë nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
- Statuti mund të kushtëzojë kalimin e kuotave, veçanërisht duke përcaktuar miratimin e shoqërisë ose të drejtën e parablensës në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë.

## Neni 10

### Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme i shumicën e kualifikuar të votave të ortakëve.
- Shoqëria mund të kryejë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave.

## Neni 11

### Blerja e Kuotave të Veta



Shoqëria mund të blerjë kuotat e veta dhe të kryejë pagesa për blerjen e tyre, jo nga fitimet e shoqërisë që do t'u shpërdahen ose fitakeve apo emetimit të kuotave të reja vetëm nëse shoqëria përmbush kushtet për shpërndarjen e fitimve sipas nenit 77 të Ligjit dhe Administratori lëshojnë një certifikatë të aftësisë paguese të parashikuara nga ky nen. Në rast se blerja e kuotave të veta nuk është në përputhje me kushtet e nenit 77 të Ligjit, paditë mbi përgjegjësinë e shoqërisë mund të ngrihen në pajtim me parashikimet e nenit 78 dhe 79 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

## Neni 12

### Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

- Administratori thërret Asamblenë e Përgjithshme dhe, me kërkesën e ortakëve sipas Nenit 84 të Ligjit, do të procedojnë me thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme.
- Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar më postë ose postë elektronike (email) drejtuar çdo ortaku, përfshirë dhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes së dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Secili ortak, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet dhe numri PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik për mbledhjen
- Kur Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, paravësisht parregullisë.

## Neni 13

### Mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme

- Asambleja e Përgjithshme merr vendime të vlefshme vetëm me artikullin e kuorumit të parashikuar nga neni 86 i Ligjit. Ortakët ose përfaqësuesit e autorizuar mund të marrin pjesë nëpërmjet mbledhjeve elektronike, përfshirë telekonferencat audio ose audio-video, në përputhje me nenin 88 të Ligjit. Ortakët që marrin pjesë me mjete komunikimi elektronik kanë të drejtë të votojnë nëpërmjet numrit PIN që iu është dërguar së bashku me njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të Ligjit, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Administratori cakton Kryetarin e mbledhjes dhe një person për të mbajtur procesverbalin e saj.
- Nëse asnjë prej personave të propozuar nuk dëshiron të aktohet si Kryetar i mbledhjes ose nëse asnjë prej tyre nuk është i pranishëm për pesëmbëdhjetë minuta duke filluar nga ora e caktuar për fillimin e mbledhjes, ortakët e pranishëm dhe me të drejtë vote zgjedhin njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- Kryetari, me pëlqimin e Asamblesë së Përgjithshme të mbledhur në përputhje me kuorumin e caktuar me ligj, mund (dhe është i detyruar nëse kërkohet nga Asambleja e Përgjithshme), të shtyjë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, por në mbledhjen e dytë mund të diskutohen vetëm ato çështje të cilat do të ishin diskutuar rregullisht nëse nuk do të ishte shtyrë mbledhja e mëparshme. Kur mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme shtyhet të paktën katërmbëdhjetë ditë, njoftimi do të kryhet të paktën shtatë Ditë të Plota përpara kësaj date dhe në të do të përcaktohet ora dhe vendi i mbledhjes së shtyrë dhe përshkrimi i përgjithshëm i rendit të ditës. Në rast të kundërt, dhënia e njoftimit nuk është e nevojshme. Asambleja e Përgjithshme vendos me votim të hapur me përjashtim të rastit kur përpara ose gjatë deklarimit të rezultatit, nuk kërkohet në mënyrën e duhur një votim i fshehtë. Votimi i fshehtë mund të kërkohet nga:

- 1) Kryetari; ose
- 2) një ortak ose ortakët që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë për qind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kërkesa e bërë nga një përfaqësues i autorizuar i ortakut ka të njëjtën vlerë me kërkesën e paraqitur nga vetë ortaku.

- Me përjashtim të kundërshtimit të një ortaku, deklarimi i Kryetarit se vendimi është marrë në mënyrë unanime, ose me një shumicë të caktuar, nuk është miratuar ose nuk është miratuar me një shumicë të caktuar dhe regjistrimi përkatës në procesverbalin e mbledhjes përbën provë përfundimtare të këtij fakti, pa pasur nevojë për numërimin e votave të regjistruara pro ose kundër vendimit.
- Në rast se ka kundërshtime për këtë deklaratë, do të zhvillohet një votim i fshehtë në lidhje me përcaktimin e numrit të votave pro dhe kundër vendimit.

#### Neni 14

##### Votat e Ortakëve

- Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, çdo kuotë i jep ortakut (në rastin kur është individ) të pranishëm apo përfaqësuesit të tij të autorizuar ose ortakut (në rastin kur është person juridik) i cili është i pranishëm përmes përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit të autorizuar në mënyrë të rregullt, të drejtën e një vote.
- Çdo kundërshtim në kohë për cilësinë e një votuesi do të komunikohet Kryetarit, vendimi i të cilit do të jetë përfundimtar. Të gjitha votat e pakundërshtuara në një mbledhje ose mbledhje të shtyrë do të jenë të vlefshme.

#### Neni 15

##### Votimi me Prokurë

- Përfaqësuesi do të emërohet nga ortaku sipas formës së mëposhtme:  
“.....SHPK..... Unë/Ne i/të nënshkruari/t, në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më ..... ose në pamundësi të tij ....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e dila do të mbahet më....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë. Nënshkruar më.....”
- Në rastet kur dëshirohet tu jepet ortakëve mundësia për të udhëzuar përfaqësuesin për mënyrën e veprimit, caktimi i përfaqësuesit bëhet sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund të miratohet nga Administratori):
- “.....SHPK..... Unë/Ne të nënshkruari/t, në cilësinë e ortakut/ortakëve të shoqërisë së lartpërmendur, emëroj/më....., ose në pamundësi të tij,....., në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.  
Kjo formë do të përdoret për vendimet e përmendura më poshtë:  
Vendimi Nr. 1 \*pro "kundër  
Vendimi Nr. 2 \*pro \*kundër.  
(\*Fshini zgjedhjen e padëshiruar).  
Përveç udhëzimeve të tjera, përfaqësuesi mund të votojë ose abstenojë, siç e quan të arsyeshme.  
Nënshkruar më.....”.
- Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në selinë e shoqërisë ose në një vend tjetër brenda territorit të Republikës së



Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

- Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (email) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpara orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

## Neni 16

### Përfundimi nga e drejta e votës

- Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse Asambleja e Përgjithshme merr vendim për:
  - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
  - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
- Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## Neni 17

### Emërimi i Administratorit

- Administratori emërohet për një mandate 5 (pesë) vjeçar. Ai zëvendësohet ose shkarkohet nga kjo detyrë me vendim të Asamblesë së Ortakëve. Mandati është i rinovueshëm.
- Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohet si administrator i një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- Administratori i parë i shoqërisë emërohet **Znj. Bruna MUSARAJ**, shtetase shqiptare, e datëlindjes 11/05/1988 banuese në Tiranë, identifikuar me Nr. I85511011S, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## Neni 18

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryej të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatis dhe nënshkruaj bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, dhe i paraqet këto dokumente përpara Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- e) kryen regjistrimet dhe dërgon të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- f) raporton përpara Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- g) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

- Administratori është i detyruar të thërras Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:
  - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% (pesë për qind) të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- Nëse Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.
- Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 19**

#### **Përfaqësimi**

- Kufizimet e tagrave të përfaqësimit të administratorit i kundrejtohen palëve të treta, në përputhje me dispozitat e nenit 12 të Ligjit 9901.
- Njoftimet e drejtuara administratorit janë të vlefshme e detyruese për shoqërinë.
- Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.
- Administratori mund t'i delegoj kompetencat e tij. Çdo delegim kompetencash mund të kryhet në përputhje me kushtet që mund të vendosi Administratori dhe mund të revokohet ose ndryshohet. Administratori nuk mund të delegoj detyrimet e tij ligjore.

#### **Neni 20**

#### **Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit**

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

- a) personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
- b) personi ndodhet në gjendje paaftësie paguese;
- c) personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
- d) personi jep dorëheqjen nga detyra duke njoftuar shoqërinë, ose
- e) ka munguar për më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e ortakeve në mbledhjet e mbajtura gjatë kësaj periudhe nga Asambleja e Përgjithshme, me propozimin e ortakeve, vendos ta shkarkojë nga detyra.

#### **Neni 21**

#### **Shpërblimi, Përfitimet e tjera dhe Shpenzimet e Administratorit**



- Administratori shpërblehet në bazë të skemës së vendosur nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me parashikimet e Nenit 97 të Ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".
- Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojë përfitime, nëpërmjet shpërblimeve në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, për çdo person i cili ka qenë por nuk është më në detyrë apo i punësuar në shoqëri, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose për shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose të filialeve të saj, ose për çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish- bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe mund të paguajë kontribute në fonde të caktuara për dhënien e përfitimeve të tilla.
- Administratorit mund t'i paguhen të gjitha shpenzimet e udhëtimit, akomodimit dhe shpenzime të tjera në lidhje me pjesëmarrjen e tij në mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me përmbushjen e detyrave të tyre.

#### Neni 22

#### Procesverbalet e Mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

Administratori kujdeset që në libra të posaçëm të mbahen procesverbalet e:

- a) të gjitha takimeve të kryera nga Administratori; dhe
- b) të gjitha mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme

#### Neni 23

#### Dividendët

- Pas plotësimit të parashikimeve të Nenit 77 të Ligjit 9901, shoqëria me shumicë të kualifikuar të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë shpërndarjen e dividendëve në përputhje me të drejtat përkatëse të ortakëve.
- Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me kuotat, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për kuotat për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për kuotat, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se kuota emetohet me kushtin e përfitimit të dividendit nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.
- Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një kuotë nuk do të mbartë interesa ndaj shoqërisë nëse nuk parashikohet nga të drejtat që lidhen me kuotën.
- Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset me shumicë të kualifikuar votash nga Asambleja e Përgjithshme, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

#### Neni 24

#### Kalimi i Fitimeve në Kapitalin Themeltar

Administratori, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të kualifikuar votash dhe duke pasur parasysh parimet e përcaktuara në nenin 14 të Ligjit 9901, mund të vendosin të kalojnë në kapitalin themeltar të shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezervat e kapitalit të shoqërisë.

#### Neni 25

#### Prishja dhe Likuidimi



Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi I veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) me vendim të gjykatës;

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Rregullat për procedurën e zakonshme të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese janë Nenet 191 deri në 203 të Ligjit 9901. Shoqëria likuidohet me procedurë të thjeshtëzuar, në përputhje me nenet 204 dhe 205 të Ligjit 9901.

## Neni 26


### Njoftimet

- Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.
- Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.
- Ky Statut së bashku me ndryshimet dhe të gjitha dokumentet e tjera, raportet, komunikimet dhe procesverbalet e dhëna nga shoqëria do të publikohet nga Administratori në faqen e internetit të shoqërisë, sipas parashikimeve të pikës 2 të nenit 4 të këtij Statuti (nëse zbatohet).

### Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve Themelues:

Datë: 01/09/2024

Znj. Bruna MUSARAJ

Bruna Musaraj  


EB INVESTMENT SHPK

Erinda Xheferri  
